



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/158
Datë: 05.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8, dhe nenit 16, paragrafi 6, nën paragrafi 6.2 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49 të Ligjit për Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi për Mbrojtjen e Konsumatorëve të Cenueshëm të Energjisë Elektrike për vitin 2023-2024.
2. Autorizohet Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve që me vendime të veçanta të përcaktojë kushtet dhe kriteret për përfitim nga Programi sipas pikës 1. të këtij Vendimi.
3. Informatat dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i Programit sipas pikës 1. të këtij Vendimi do të përdoren për draftimin e Programit të detajuar për trajtimin e mbrojtjes së konsumatorëve të cenueshëm, në linjë me kërkesat e Ligjit përkatës për Energji Elektrike.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Programit nga pika 1. e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/158
Datë: 05.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8, dhe nenit 16, paragrafi 6, nën paragrafi 6.2 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-213 dhe Ligjin Nr.08/L-235, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, dhe Vendimin Nr. 20/140 të datës 26.04.2023, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 2,500,000 € (dy milionë e pesëqind mijë euro) në zbatim të Masës 4.3 - Mbështetja e Kulturës dhe Sportit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Mjete sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me kod 207, nën-programi "Sportet e Gjëra" me kod 80100, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet sipas këtij vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programin përkatës.
4. Mjetet sipas të këtij Vendimi mund të përdoren nga Ministria së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për mbulesën e shumës së garancisë për cedimin e të drejtave ekskluzive të Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030.
5. Me rastin e miratimit të kandidaturës të Republikës së Kosovës për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030, autorizohet Ministria së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit me Komitetin Olimpik të Kosovës për realizimin e pagesave tek Komiteti Ndërkombëtar i Lojërave Mesdhetare, sipas kontratës me Komitetin Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare.
6. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
PER 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/158
Datë: 05.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8, dhe nenit 16, paragrafi 6, nën paragrafi 6.2 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Programi për zbatimin e Strategjisë së Energjisë së Kosovës për periudhën 2022-2025.
2. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Programit nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë